


Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Janar 2022

HAKERËT PO AKSESOJNË LLOGARITË E CEO-VE ME ANË TË APLIKACIONEVE MASHTRUESE OAUTH



Analistët e sigurisë kanë vëzhguar një nismë të re të quajtur "OiVaVoii", duke patur target drejtuesit e kompanive dhe menaxherët e përgjithshëm me aplikacione keqdashëse të OAuth dhe mashtrime të personalizuar (phishing) të dërguara nga llogaritë e vjedhura të Office 365.

Sipas një raporti nga Proofpoint, nisma është ende në vazhdim, megjithëse Microsoft po monitoron aktivitetin dhe tashmë ka bllokuar shumicën e aplikacioneve.

Ndikimi i marrjes së llogarive ekzekutive varion nga lëvizja në rrjet dhe phishing te brendshëm deri te vendosja e ransomware dhe incidentet e komprometimit të emailve të biznesit.

KAMERAT E SIGURISË TË LIDHURA ME WIFI MUND TË MANIPULOHEN LEHTË



Cisco Talos zbuloi kohët e fundit disa dobësi në kamerën e sigurisë Reolink RLC-410W që mund të lejojë një sulmues të kryejë disa veprime me qëllim të keq, duke përfshirë kryerjen e sulmeve man in the middle, vjedhjen e kredencialeve të përdoruesit dhe më shumë.



DITA E MBROJTJES SË TË DHENAVE

Të dhënat tuaja personale janë të rëndësishme. Në Bashkimi Evropian, mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore.

Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) zbatohet në të gjithë BE-në dhe ju jep më shumë kontroll mbi të dhënat tuaja personale. Është bërë pikë referimi globale për rregullimin e privatësisë.

Gjithnjë e më shumë, GDPR po bëhet gjithashtu themeli i politikave dixhitale mbi të cilën po ndërtohen nisma në kuadër të Strategjisë Dixhitale Evropiane.

Evropa jo vetëm që po siguron rregulla të forta të privatësisë në shtëpi, por po udhëheq këtë nismë globalisht.



SHUMICA E RANSOMWARE JANË TË VETË- INSTALUAR

Studimi i ri nga ofruesi i "Managed Detection and Response" (MDR) Expel zbuloi se shumica e sulmeve të ransomware në 2021 ishin të vetë-instaluar.

Studiuesit zbuluan se tetë nga dhjetë ransomware ndodhën pasi viktimat padashur hapën një skedar zip që përmbante kod me qëllim të keq. Abuzimi i aksesit të palëve të treta përbënte 3% të të gjitha incidenteve të ransomware dhe 4% u shkaktuan nga shfrytëzimi i një cenusshmërie softueri në perimetër.

[Most Ransomware Infections are Self-installed - Infosecurity Magazine \(infosecurity-magazine.com\)](https://www.infosecurity-magazine.com)